



03/11/2010
"TELEGRAFI"

Kërko

USAID ndihmon të rinjtë për punësim profesional

Shpërndaje **16** Postuar: 14:34 / 2.11.2010 **Komente:** 0

Mbështetja e USAID-it ofruar për trajnimin dhe programet e praktikës për studentët e universitetit, ka rezultuar në punësimin profesional të 75 të rinjve.

Drejtori i KPEP-it, Mark Wood, tha se USAID-i e konsideron zhvillimin e fuqisë punëtore si strategji kryesore në përmirësimin e pozitës konkurruese të kompanive dhe sektorëve të Kosovës.

"Për t'iu ofruar studentëve, të papunëve dhe të punësuarve aktualë shkathhtësitë të cilat i përshtaten më mirë biznesit, Programi për Ndërmarrje Private në Kosovë ka organizuar disa programe të praktikës", tha Wood.

Trajnimi dhe programi i praktikës në kontabilitet dhe financa, i implementuar nga Shoqata për Shërbime Financiare dhe Kontabilitetit (AFAS), ka inkuadruar 103 studentë të ekonomisë. Këta studentë kanë ndjekur programin e trajnimit dhe u vendosën si praktikantë nëpër banka dhe institucione mikrofinanciare. Deri më sot, 59 studentëve u janë vazhduar kontratat.

Nga programi i praktikës për fusha të ndryshme, i implementuar nga World University Service – Austria (WUS – Austria), përfituan 40 studentë. Këta studentë u vendosën në ministri dhe drejtori të ndryshme komunale të pesë komunave. Deri më tani, 2 prej tyre u është ofruar mundësi punësimi permanent.

Programi i praktikës për sektorin e prodhimeve të qumështit, i implementuar nga Nisma për Zhvillim të Bujqësisë së Kosovës (IADK), ka inkuadruar 15 praktikantë: 10 studentë fillestare dhe 5 mentorë, të cilët ishin zgjedhur nga pilot grupi i programit të vitit 2009. Programi prapë dëshmoi të jetë shumë i suksesshëm për shkak se edhe cilësia e qumështit të prodhuar nga fermerët, që ishte po ashtu pjesë e programit, është përmirësuar. Po ashtu ka pasur edhe programe dhe trajnime të tjera. /Telegrafi/

Like Florin Sejdiu and 15 others like this.



Dërgo një koment



opinione



Jo, se na nevojitet



Politika tatim ore në Kosovë, objektivat dhe rezultatet e saj



Qeveria "vjelë" vreshtarët

- › Banka e Shqipërisë lehtëson mbikëqyrjen e bankave
- › Zvogëlohet parashikimi për rritjen ekonomike të Rusisë
- › USAID ndihmon të rinjtë për punësim profesional
- › BP-ja rikthehet tek fitimi
- › Kriza ekonomike 30 milionë të papunë në botë
- › Haxha merr 10.453 euro si pagë të tetorit
- › Projektet e mëdha pezull
- › FMN vlerëson Eurobodin shqiptar
- › Shqipëri: Bëhet regjistrimi i pronave në bregdet
- › Rritet vlera e dollari
- › Turizmi, "Top 10", Piramida në majë
- › Buxheti 2011: Pasojat e zvarritjes
- › Shitja e aseteve përmes likuidimit
- › Protestuan punëtorët e Trafikut Urban
- › Shpallet tenderi për tunelin Tiranë-Ebasan
- › Program social për punëtorët e mbetur papunë nga privatizimi
- › 200 milionë euro në ditë qarkullon ekonomia shqiptare
- › Borxhet, ngarkesë për buxhetin
- › Brokerët kundër shkurtimit të pauzës
- › Prodhuesit kosovarë në prag të kolapsit